



Technical Assistance for Strengthening the Capacity of the Ministry of Environment, Forests and Water Administration in Albania for Law Drafting and Enforcement of National Environmental Legislation

A project for Albania funded by the European Union

Draft

Rregullore

“Për trajtimin e llojeve të faunës së egër në zooparqe apo në mjedise të tjera ku individët i ekspozohen publikut”¹

Draft 1

Versioni 2

28 Maj 2014

¹ ¹Kjo rregullore përaftron direktivën 1999/22/EC të 29 Marsit 1999 në lidhje me mbajtjen e kafshëve të egra në zooparqe. Numri CELEX 31999L0022. Fletorja Zyrtare L 94 , 9/04/1999 faqe. 0024 – 0026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

RREGULLORE

(Draft 1, Versioni 2 date 28.05.2014)

Nr. _____, datë _____

“PËR TRAJTIMIN E LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR NË ZOOPARQE APO NË MJEDISE TË TJERA KU INDIVIDËT I EKSPOZOHEN PUBLIKUT”²

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe nenit 26, paragrafi 2 të Ligjit nr.10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” të ndryshuar, Ministri i Mjedisit

VENDOSI

1. Miratimin e Rregullore “Për trajtimin e llojeve të faunës së egër në zooparqe apo në mjedise të tjera, ku individët i ekspozohen publikut”.
2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të garantojë mbrojtjen e kafshëve të egra në zooparqe dhe kontributin e tyre më pas në ruajtjen e biodiversitetit.
3. Për qëllime të kësaj rregulloreje "zooparqe" janë të gjitha vendet e përhershme ku kafshët e llojeve të egra mbahen për ekspozim për publikun për 7 ose më shumë ditë në vit. Përjashtohen nga kërkesat e kësaj rregulloreje cirqet, dyqanet e kafshëve dhe vendet të cilat nuk ekspozojnë për publikun një numër të konsiderueshëm kafshësh ose llojesh dhe nuk bien në kundërshtim me kërkesat e kësaj rregulloreje.
4. Personi fizik ose juridik që përdor llojet e faunës së egër për zooparqe zbaton masat ruajtëse të mëposhtme:
 - a. merr pjesë në:
 - i. kërkime nga të cilat rriten përfitimet për ruajtjen e llojeve; dhe/ose
 - ii. trajnime për aftësi ruajtje përkatëse, dhe/ose

²Kjo rregullore përaftron direktivën 1999/22/EC të 29 Marsit 1999 në lidhje me mbajtjen e kafshëve të egra në zooparqe. Numri CELEX 31999L0022. Fletorja Zyrtare L 94 , 9/04/1999 faqe. 0024 – 0026.

- iii. shkëmbimet e informacionit në lidhje me ruajtjen e llojeve dhe/ose kur është e përshtatshme, riprodhimin në robëri, ripopullimin ose riintroduktimin e llojeve në gjëndje të egër;
 - b. promovon ndërgjegjësimin dhe edukimin publik për ruajtjen e biodiversitetit, veçanërisht duke siguruar informacion rreth llojeve të ekspozuara dhe habitateve të tyre natyrore;
 - c. akomodon kafshët e tij në kushte që kanë si qëllim të plotësojnë kërkesat biologjike dhe të ruajtjes së llojeve të vecanta, ndër të tjera, duke i siguruar llojeve brenda rrethimeve kushte specifike shtesë;
 - ç. mban një nivel të lartë të administrimit të kafshëve me një program të zhvilluar ushqimi dhe kujdesi veterinar parandalues dhe kurativ;
 - d. parandalon largimin e kafshëve me qëllim shmangien e rreziqeve të mundshme ekologjike në llojet vendase dhe parandalon futjen e kafshëve të huaja të dëmshme dhe të bezdishme;
 - dh. mban të dhënat e përditësuara të koleksionit të zooparkut të përshtatshëm për llojet e regjistruara.
5. Në rast se zooparku ose një pjesë e tij mbyllet, organet e kontrollit të përcaktuar në nenin 40 të ligjit nr.10006, date 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” të ndryshuar sigurojnë që kafshët e zooparkut të trajtohen ose vendosen në kushte të cilat Ministria i mendon të përshtatshme dhe në përputhje me qëllimin dhe dispozitat e kësaj rregulloreje.
 6. Organet e kontrollit të përcaktuar në nenin 40 të ligjit nr.10006, date 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” të ndryshuar ngarkohen me kontrollin e zbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje.
 7. Organet e kontrollit hartojnë dhe dorëzojnë në Ministri çdo 3 vjet raportin në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Kjo rregullore hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

LEFTER KOKA